




Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit AK: QENDRA E STUDENTEVE OE ankues: N.T.Sh. "Delfina" N.T.G. "Blendi" "Europrinty" Sh.p.k.	Kopje	Paneli Shqyrtues – OSHP: Nr. 269/19 Nr. 271/19 Nr. 279/19
Prej:	Sahit Beqiri – Ekspert shqyrtues i prokurimit 		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesat me Nr. 269, 271, 279/19 të parashtruar nga OE: N.T.Sh. "Delfina", N.T.G. "Blendi", "Europrinty" Sh.p.k.		
Datë	11.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën me datën: 31.05.2019 me Nr. 269,271/19 të parashtruar nga OE: "N.T.Sh. "Delfina" - Malishevë, N.T.G. "Blendi" – Prishtinë, dhe ankesa me datë: 03.06.2019 me Nr. 279/19 të parashtruar nga OE: "Europrinty" Sh.p.k. - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me mobilje për nevoja të konvikteve në Qendër të Studenteve" – Lot: 2, 3, 4, me nr. prokurimi: 1020890500-19-1786-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): QENDRA E STUDENTEVE.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:


- Autoritetit Kontraktues – Qendra e Studentëve - Prishtinë
- Panelit Shqyrtues – OSHP - Prishtinë
- OE ankues – N.T.Sh. "Delfina"- Malishevë  
N.T.G. "Blendi" - Prishtinë  
"Europrinty" Shpk - Prishtinë

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE: N.T.Sh. "Delfina" - Malishevë, N.T.G. "Blendi" – Prishtinë, "Europrinty" Shpk – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi me mobilje për nevoja të konvikteve të Qendrës së Studenteve, Lot 2, 3 dhe 4, me nr. prokurimi: 1020890500-19-1786-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Qendra e Studenteve.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit AK: QENDRA E STUDENTEVE OE ankues: N.T.Sh. "Delfina" N.T.G. "Blendi" "Europrinty" Sh.p.k.	Kopje	Paneli Shqyrtues – OSHP: Nr. 269/19 Nr. 271/19 Nr. 279/19
Prej:	Sahit Beqiri – Ekspert shqyrtues i prokurimit 		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesat me Nr. 269, 271, 279/19 të parashtruar nga OE: N.T.Sh. "Delfina", N.T.G. "Blendi", "Europrinty" Sh.p.k.		
Datë	11.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën me datën: 31.05.2019 me Nr. 269,271/19 të parashtruar nga OE: "N.T.Sh. "Delfina", N.T.G. "Blendi" dhe ankesa me datë: 03.06.2019 me Nr. 279/19 të parashtruar nga OE: "Europrinty" Sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me mobilje për nevoja të konvikteve në Qendër të Studenteve" – Lot: 2, 3, 4, me nr. prokurimi: 1020890500-19-1786-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): QENDRA E STUDENTEVE.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

*Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.*

*Ti dorëzohet:*

- Autoritetit Kontraktues – Qendra e Studentëve - Prishtinë
- Panelit Shqyrtues – OSHP - Prishtinë
- OE ankues – N.T.Sh. "Delfina"- Malishevë  
N.T.G. "Blendi" - Prishtinë  
"Europrinty" Shpk - Prishtinë

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE: N.T.Sh. "Delfina" - Malishevë, N.T.G. "Blendi" – Prishtinë, "Europrinty" Shpk – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi me mobilje për nevoja të konvikteve të Qendrës së Studenteve, Lot 2, 3 dhe 4, me nr. prokurimi: 1020890500-19-1786-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Qendra e Studenteve.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY  
RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

	06.06.2019	06.06.2019	11.06.2019
Nënshkrimi i ekspertit	Data e autorizimit të ekspertit	Data e fillimit të ekspertizës	Data e dorëzimit të raportit

**N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit**

Me datën: 31.05.2019 OE: "N.T.Sh. "Delfina", N.T.G. "Blendi", kanë parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, dhe me datë 03.06.2019 OE: "Europrinty" Sh.p.k., ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me mobilje për nevoja të konvikteve ne Qender te Studenteve"-Lot:2,3,4, me nr. prokurimi:1020890500-19-1786-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): QENDRA E STUDENTEVE.

Ju njoftoj se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit nuk është nxjerr ndonjë njoftim/vendim nga OSHP-ja.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

**N.111, LPP - Operatori Ekonomik Ankues: N.T.Sh. "Delfina" - Malishevë**

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues: N.T.Sh. "Delfina" - Malishevë janë:

AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit konkretisht gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve ka bere shkelje te dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092.

-AK ka shkelur nenin 1, 6, 7, 59.4, 60.1.1, të LPP të amendamentuar.

**DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:**

Shkelja 1. AK gjatë fazës së vlerësimit të tenderit ka bere shkelje te LPP-se ne nenet e cekura ne piken 6 (dispozitat e shkalura nga AK), duke mos vlerësuar drejt kur ka konstatuar te shpalle fitues për LOT II "Furnizimi me dollap dhe komoda" OE "Mali-I" – Mitrovicë dhe për LOT III "Furnizimi me karrika "BURSAM GOLD" SHPK – Prishtinë.

AK NUK I KA VLERESUAR OFERTAT FINANCIARE ME CMIM ME TE ULET TE OFERTUAR NGA NE SI OE për Lot nr. 2 dhe Lot nr. 3.

Kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-se qe ankesën tone ta e pranoj si te bazuar dhe ketë procedurë te kthej ne rivlerësim ne mënyrë qe AK te ketë mundësi te i eliminon shkeljet e bëra.

Pretendimet ankimore janë të njëjta me kërkesën për rishqyrtim pran AK – Qendra e Studentëve

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE: N.T.Sh. "Delfina" - Malishevë, N.T.G. "Blendi" – Prishtinë, "Europrinty" Shpk – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi me mobile per nevoja te konvikteve te Qendres se Studenteve, Lot 2, 3 dhe 4, me nr. prokurimi: 1020890500-19-1786-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Qendra e Studenteve.



**N.111, LPP - Operatori Ekonomik Ankues: N.T.G. "Blendi" – Prishtinë.**

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues: **N.T.G. "Blendi" - Prishtinë** janë:

Neni 1 – Qëllimi  
Neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti  
Neni 7 – Barazia ne Trajtim/Jo-diskriminimi  
Neni 28 – Specifikimet teknike  
Neni 52.3 – Njoftimi i kriterëve për dhënie të kontratës  
Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve  
Neni 18 i Udhëzuesit operativ – Dosja e tenderit  
Neni 20 i Udhëzuesit operativ – Specifikimet teknike  
Neni 108/A pika 2 Pezullimi aktivitetit të prokurimit

**DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:**

AK/Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave për tenderin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik.

AK gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka respektuar dispozitat ligjore të lartcekura, kompania jone nuk është trajtuar barabartë me OE tjerë pjesëmarrës. Shkelje esenciale nga AK është mosrespektimi i nenit 52.3 të LPP-se, pasi që AK gjatë vlerësimit të ofertave nuk është bazuar në kushtet dhe kriteret e cekura në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit por ka përdorur kriterë jo të matshme të cilat me pare nuk janë cekur në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, citoj: 3. Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim.

Se bashku me ofertën tek AK kemi dorëzuar deklaratën e specifikimeve teknike me të cilën i kemi garantuar AK se materialet e ofruara për projektin në fjalë janë në përputhshmëri të plote me specifikimet teknike si në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Shkelja esenciale nga AK është se kompania jone pasi që është shpallur fituese për Lot 4 me ane të njoftimit mbi vendimin e AK të datës 06.05.2019, na janë kërkuar mostrat e produkteve para nënshkrimit të kontratës dhe AK ka vendosur për eliminimin e kompanisë sonë edhe pse mostrat e ofruara janë në pajtim me kërkesat e AK si në ANEKS 1 Specifikimet teknike të detyrueshme. Për hire të transparencës dhe korrektësisë edhe pse dorëzimi i mostrës nuk ka qenë kërkesë-kriter në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit në kemi dorëzuar mostrat tek AK dhe mostrat e dorëzuara janë në përputhje të plote me specifikimet dhe në harmoni me ofertën e kompanisë /konsorciumit tone.

Edhe në rast se nuk do të dorëzonim mostrat fare AK nuk ka të drejtë të eliminojë kompaninë tone pasi që ka vendosur paraprakisht gjatë fazës së vlerësimit të na rekomandojë fitues me ane të njoftimit mbi vendimin e AK-se dhe letër standarde.

Eliminimi i kompanisë sonë pa nxjerrë njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues me ane të cilit njëkohësisht duhet njoftuar të gjitha palët pjesëmarrës përben shkelje ligjore dhe nuk lejohet me ligj dhe praktikë të prokurimit prandaj si përfundim ju lutem që aktivitetin e prokurimit të ktheni në ri-vlerësim, ankesa e kompanisë sonë të aprovohet si e bazuar dhe në ri-vlerësim të trajtohem barabartë me të gjithë OE tjerë dhe të shpallet kompania jone fituese për Lot 4 me vendimin e dt. 06.05.2019 pasi që plotësojmë të gjitha kërkesat/kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit si dhe kemi çmimin me të ulët.

AK – zyra e prokurimit gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë ka shkelur nenin 108/A pika 2 të LPP-se pasi që nuk ka pezulluar aktivitetin e prokurimit edhe pse ka pranuar sipas afatit ligjorë ankesën/kërkesën për rishqyrtim nga kompania jone.

**Pretendimet ankimore janë të njëjta me kërkesën për rishqyrtim pran AK – Qendra e studentëve.**



### N.111, LPP - Operatori Ekonomik Ankues: "Europrinty" Sh.p.k. – Prishtinë.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues: "Europrinty" Sh.p.k. – Prishtinë, janë:

- Neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti
- Neni 7 – Barazia ne Trajtim/Jo-diskriminimi
- Neni 28 – Specifikimet teknike
- Neni 41 i A01 Udhëzuesit Operativ
- Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës

#### Dëshmitë dhe faktet

Po ashtu ne kemi parashtruar kërkesë për Rishqyrtim. Mirëpo nga AK kemi marr refuzim te kërkesës tone edhe pse i kemi përgatitur dëshmi dhe faktet substanciale.

### DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Ne si OE jemi eliminuar nga ky tender me arsyetimin se tenderi ynë nuk ishte i suksesshëm pasi kemi paraqitur ofertën apo tenderin jo normalisht te ulet.

Ne e kundërshtojmë si te pabazuar vlerësimin dhe dhënien e kontratës OE fitues ne fjale, ne vijim do i përshkruajmë faktet dhe argumentet qe bazohet kërkesa jone si ne vijim:

-Me anulimin e këtij aktiviteti është bere diskriminim i dispozitave ligjore ne fuqi ku është bere shkelje edhe e nenit 7 te LPP-se paragrafi 1 dhe 2 ku e citojmë dispozitën ligjore si ne vijim:

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik –

#### Neni 28 Specifikimet teknike

2. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

#### Neni 41 I A01 Udhëzuesit Operativ

41.1 Tenderët e pranuar me kohe te paraqitur nga OE do te ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen ne përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara ne njoftimin për kontrate/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i epet tenderuesit qe ka renditjen me te larte. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund te ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa te përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacione ose te shtojnë disa te reja gjate procedurës se prokurimit.

Po ashtu është bere shkelje e dispozitave ligjore neni 59 I LPP-së, pasi komisioni i vlerësimit nuk ka bere ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimi i tenderëve ne mënyrë jo te duhur te tenderit ne fjale, duke anashkaluar krahasimin e saktë te tenderëve.

Ne këtë aktivitet si kriter për dhënie te tenderit ka qene çmimi me i ulet, me këtë rast është bere shkelje e nenit 61 te LPP-se, për arsye se:

Autoriteti kontraktues - Qendra e Studenteve fillimisht ka dërguar tek ne një letër standard e kërkesë për informata mbi tenderët jo-normalisht te ulet me date 02.05.2019 ku na ka pyetur se a qëndrojmë pas ofertës se dhënë, dhe ne me date 04.05.2019 ju kemi përgjigjur me një shkresë deklarate ku kemi dokumentuar fakte qe ne i qëndrojmë pas ofertës sonë dhe çmimit te dhënë për LOT 3 "Furnizimi me karrika"

Pra me date 06.05.2019 ne jemi informuar se kemi dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin me te ulet te ofertuar qe ka qene edhe kriter për dhënie te kontratës, dhe me këtë rast ne jemi shpërblyer me kontrate. Pas kësaj AK ne fjale n'a ka dërguar ne forme te shkruar se ne duhet ta sjellim mostrën fizike deri me date 13.05.2019.

Ne pas përpjekjeve te mëdha me prodhuesit tone qe na s'përtojnë ne këtë Project e kemi beret e pamundurën dhe ja kemi dale ta sjellim mostrën ne datën e caktuar e cila ka ardh nga Kina sepse mostra këtu nuk ka asnjë operatore ekonomik dhe asnjë operatore ekonomik nuk e ka tere atë sasi e cila është kërkuar nga AK ne fjale.

Pas dorëzimit te mostrës ne kemi marr pas 2 dite një njoftim letër standard për eliminim me arsyetimin se mostra jone nuk i ka përmbushur specifikat teknike.



Autoriteti Kontraktues ka bere cenim te dispozitive ligjore ne fuqi me rastin e mostrës, sepse ne mostrën e kemi pasur konform specifikave teknike te cekura dhe e kemi pasur mbi specifika, gjithashtu me rastin e dorëzimit te mostrës ne kemi dorëzuar edhe një deklarate ku kemi konfirmuar se ne qëndrojmë pas çdo specifike te kërkuar ne nga dosja. Karrikat e prezantuar nga ana jone është edhe me e mire se ne foto te cilën e kane AK, karrika ka eco lëkur ne ulësen gjithashtu ne kemi prezantuar mostrën edhe ne mbështetëse eco lëkure qe është ma e mire se rrjeta dhe ka qene e lartësisë siç është kërkuar.

AK ka bare shkelje Ligjore te LPP-se me saktësisht te nenit 28 Specifikimet teknike, dhe ne si pale e pakënaqur do te ankohe mi nëse kjo kërkesë e jona nuk merret parasysh ankesën tone do ta adresojmë ne OSHP, sepse vet AK ka bere disbalanc ne specifikime teknike tek dosja e tenderit, tek specifikimet teknike dhe tek lista Excel me specifikat teknike, ku dallojnë dhe kane distance me foton e prezantuar aty, ndërsa neve njësia kërkuese dhe personi përgjegjës na ka informuar qe te sillet krejt tjetër karrik, këtu vet Autoriteti Kontraktues bijën ndesh me vetveten ne specifikat e cekura dhe te bere publike me ato tani se çka kërkojnë.

**Dhe si përfundime e kundërshtojmë këtë vendim për eliminim qe na është bere pa te drejt dhe gjithashtu kundërshtojmë VENDIMIN e komisionit si vendim i pa drejt dhe vendim manipulues dhe me tendence.**

Autoriteti Kontraktues ka shpallur dhe pretendon te beje dhënien e kontratës OE ne fjale ku I cili nuk i plotëson kriteret për kualifikim sepse tash i cekëm faktet dhe dëshmitë tona ne lidhje me këtë proces si ka shkuar.

*Se pari ky OE ka dorëzuar vetëm referenca e nuk ja ka bashkangjitur kontratat si dëshmi se ato kontrata janë te përfunduar, pas analizës qe i bëmë del te jete se ky OE nuk I ka qarkullimin për LOT 3 KARRIKA qe kërkohe sepse referencat te cilat I posedon nuk ja përbushin këtë kriter dhe gjithashtu ka referenca me artikuj te tjerë produkte tjera.*

Gjithashtu, ne shprehim shqetësimet tona ne lidhje me këtë aktivitet sepse këtu ka pasur manipulime dhe tendenca favorizimi për këtë OE ne fjale, sepse ne OE EUROPRINTY SHPK kemi qene me çmimin me te lire dhe kemi qene te përgjegjshëm, ndërsa neve na u është manipuluar kur ne është kërkuar mostra, ne kemi qene për ta shikuar mostrën se pari jemi konsultuar te departamenti i prokurimit prej aty na kane thënë se duhet te shkojmë ne Konviktin nr. 7 për te shikuar mostrën se si duhet te jete edhe ashtu siç mostra duhet te sillet, aty ne konviktin nr. 7 na ka pritur përgjegjësi me emrin Avdi, ky i nderuar na ka thënë se mostra e karriges duhet te sillet ashtu siç na ka thane dhe ne kemi beret e pamundurën për ta gjetur ashtu identike mostrën edhe pse ne tregun tone nuk ka pasur këto behën vetëm me porosi nga China ne kemi beret e pamundurën dhe ditën e fundit te cilën e kemi pasur për ta dorëzuar ne kemi dërguar një mostër te ngjashme me te cilën ata na kane kërkuar.

Pas kësaj neve na u është kthyer një përgjigje nga komisioni qe me demek neve nuk na është pranuar kjo mostër dhe për shkak te kësaj na kane eliminuar, nuk e kane shikuar si duhet mostrën nuk e kane lexuar deklaratën tone te cilën e kemi dorëzuar se bashku me mostrën ku ne jemi zotuar me përgjegjësi te plote se do te behet liferimi ashtu sipas specifikave teknike te cekura.

Autoriteti Kontraktues pastaj ka shpallur fitues OE me renditje te 4 ose 5 ne proces verbalin e hapjes se tenderit me c ‘rast krejt kjo ka ardhur sepse ka pasur tendenca te favorizimit për këtë OE ne fjale. Sepse me këtë OE kane punuar edhe me herët AK duke anashkaluar OE te tjerë dhe duke e minimizuar konkurrencën e mirëfilltë. Kjo bijën ndesh me ligjin ne fuqi te e-prokurimit – LPP-së.

Autoriteti Kontraktues ne këtë raste ka bere shkelje te rende ligjore duke e dëmtuar për shume fish buxhetin e saj duke pretenduar te shpalle fitues OE me çmimin dyfish me te larte se ne. Është e pa diskutueshme qe këtu kemi te bëjmë me favorizim sepse ato karrika te cilat kane për tu furnizuar çmimi i saj është shume i ulet, mundeni edhe vet te dilni ne treg dhe ta shikoni. Ne do ta kundërshtojmë ne maksimum këtë proces dhe këtë pretendim për ta shpall këtë OE fitues sepse është i papërgjegjshëm dhe është me çmim shume me i larte dhe kjo e dëmtton buxhetin dhe nuk është ne harmoni me kriterin për dhënie te kontratës ku është çmimi me i ulet i përgjegjshëm.

Gjithashtu, ky OE ka dorëzuar karrike mostër jashtë specifikave teknike dhe jashtë asaj te cilës neve na u është kërkuar, ndërsa kur ishim aty fizikisht për ta pare mostrën fjalët kane ndryshuar, dhe tash ju keni theksuar se kjo karrige është e duhur, është për tu çuditur fakti se si bëni lloje lojna dhe kesi manipulime te cilat ne do ti qojmë deri ne fund ne zbardhjen e tyre. Ne si OE EUROPRINTY ne keni thënë mostrën me sjell ndryshe vetëm për shkak qe me na vështirësua punën me tendë qe mos me mundur ta gjejmë atë mostër, por ne kemi gjetur identikes na keni thënë dhe duhet me ju ardh marre dhe keq ardhje njësisë kërkuese dhe personit përgjegjës se çfarë vlere te parashikime kane lenë për këtë LOT me KARRIKA aq shume me dëmtua buxhetin ku ajo karrige vjen me një çmim shume shumë te volitshëm.

Andaj ne baze te atyre qe larte cekëm ne si operator ekonomik qe ky tender te ri-vlerësohet.

**Pretendimet ankimore janë të njëjta me kërkesën për rishqyrtim pran AK – Qendra e studentëve.**



## Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë: .....	05.04.2019
Lloji i procedurës së aplikuar:.....	Procedurë e hapur - Furnizim
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:.....	Kontratë publike kornizë – Me Një OE, 15 muaj
Vlera e parashikuar e kontratës:.....	595,000.00 €
Kriteri për dhënie të kontratës (N.52).....	Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....	26.04.2019
Data e hapjes së ofertave.....	26.04.2019
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave.....	06.05.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderuesin e pasukseshem .....	06.05.2019
Data e njoftimit mbi Vendimin e AK - B58 .....	06.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim.....	13.05.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....	15.05.2019
Data e përfundimit të Ri-vlerësimit të ofertave.....	21.05.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderuesin e eliminuar .....	21.05.2019
Data e njoftimit mbi Vendimin e AK - B58 .....	21.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim.....	20.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim.....	25.05.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....	21.05.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....	27.05.2019



## Kriteret për vlerësim:

### III.2 KUSHTET PËR PJESËMARRJE

#### III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë

##### Kërkesat e përshtatshmërisë:

###### Kërkesat:

- a) Deklarata nën betim, që tenderuesi i plotëson kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr04L-042).
- b) Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore, se ju nuk keni obligime borxhe të tatimeve në ATK. Vlefshmëria e vërtetimit duhet të jete maksimumi 90 dite nga data e lëshimit deri në datën e hapjes së ofertave. Vërtetimi kërkohet origjinal ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërbllim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit për Dhënie të Kontratës
- c) Dëshmi se kompania (biznesi) nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata kompetente. Vërtetimi kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërbllim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit për Dhënie të Kontratës dhe nuk duhet të jete më i vjetër se 180 dite nga c). Vërtetimi nga gjykata kompetente (Origjinal ose kopje e noterizuar) data e lëshimit deri në ditën e dhenies.

##### Dëshmia e kërkuar dokumentare:

###### Evidencat: Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë:

- a). Deklarata nën betim e nënshkruar dhe e vërtetuar (ky dokument është pjesë e dosjes).
- b). Vërtetimi i ATK (i verifikuar në web faqen e ATK-se).
- c) Vërtetimi nga gjykata kompetente (Origjinal ose kopje e noterizuar).

#### III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

##### Përshtatshmëria profesionale:

###### Kërkesat:

- Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit (kopje).
- Çertifikata e Numrit Fiskal, nëse nuk është e përfshirë në certifikatën e biznesit (kopje).
- Çertifikata për Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK (kopje).

##### Dëshmia e kërkuar dokumentare:

###### Evidencat:

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit, se ashku me dokumentin Informatë mbi Bizneset kopje
- Çertifikata e Numrit Fiskal, nëse nuk është e ërfshirë në certifikatën e biznesit (kopje).
- Çertifikata për Regjistrim në TVSH (kopje).

#### III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

##### Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

###### Kërkesat:

- Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë tre viteve të fundit një xhiro totale në EURO të barabartë ose më shumë se
- |               |              |               |              |               |             |               |             |
|---------------|--------------|---------------|--------------|---------------|-------------|---------------|-------------|
| 1. Për lot 1, | 220,000.00 € | 2. Për lot 2, | 215,000.00 € | 3. Për lot 3, | 75,000.00 € | 4. Për lot 4, | 85,000.00 € |
|---------------|--------------|---------------|--------------|---------------|-------------|---------------|-------------|
- Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për disa pjesë (lote), shuma totale e qarkullimit financiar që kërkohet për Lotet për të cilat ai konkurren duhet të përmbushet nga OE minimalisht në vlerën e lot-it më të madh. Kjo shumë për të gjitha Lotet mjafton të jetë 595,000.00 €.

##### Dëshmia e kërkuar dokumentare:

###### Evidencat:

- Evidenca 1 Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit, deri në ditën e këtij njoftimi. Operatori ekonomik që përmbush kërkesën e qarkullimit vetëm me një, dy apo tri vite ka përmbushur kërkesën minimale të përcaktuar në dokumentet e tenderit, kusht i domosdoshëm dhe i detyrueshëm për t'u kualifikuar. Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për dy apo me shume pjesë (lote), shuma totale e qarkullimit financiar që kërkohet për Lotet për të cilat ai konkurren duhet të përmbushet nga OE. Minimalisht kjo shumë për Lotet mjafton të jetë sipas ndarjes së kërkuar në baze të llotove.

#### III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

##### Kapaciteti teknik dhe profesional:

###### Kërkesat:

- Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit deri në ditën e njoftimit për kontratë. jo më pak se;
- |             |                 |
|-------------|-----------------|
| 1. LLoto 1  | 220,000.00 Euro |
| 2. LLoto 2  | 215,000.00 Euro |
| 3. Llotot 3 | 75,000.00 Euro  |
| 4. LLoto 4  | 85,000.00 Euro  |

OE duhet të ofrojë garancion i kërkuar në specifikimin teknikne DT

##### Dëshmia e kërkuar dokumentare

###### Evidencat:

- Evidenca 1 Një listë të furnizimeve të realizuara në 3 vitet e fundit, deri në ditën e njoftimit për kontratë, duke saktësuar produktet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij liferimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij liferimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i liferimit të tillë si dhe dëshmia për kryerjen e pageses (transaksioni bankar).

Garancioni duhet të ofrohet ashtu siq është kërkuar në DT, i nënshkruar dhe i vërtetuar nga OE

3.B



## Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr.	Operatorët Ekonomik	Vendi	Pjesë	Çmimi €	Vlera e parashikuar	Vërejtje & E-prokurimi
1.	N.T.SH. "Delfina"	Malisheve	Lot 2	162592.00 €	<b>595000.00 €</b>	JO / E-prokurim elektronik
			Lot 3	40000.00 €		
2.	"Bursa, Gold" Shpk	Prishtinë	Lot 3	51500.00 €		JO / E-prokurim elektronik
			Lot 4	86260.00 €		
3.	N.P.T. "Mali-I"	Mitrovicë	Lot 2	186121.40 €		JO / E-prokurim elektronik
			Lot 3	53100.00 €		
			Lot 4	99297.00 €		
4.	"Europrinty" Shpk	Prishtinë	Lot 3	35000.00 €		JO / E-prokurim elektronik
5.	Grupi OE: NTG: "Blendi" & NPSH "Eloni"	Prishtinë	Lot 3	48500.00 €		JO / E-prokurim elektronik
			Lot 4	79210.00 €		

## Komisioni ri-vlerësues pranë AK:

### Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues:

Autoriteti Kontraktues për Ri-vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Shkurta Dajaku – Kryetar i komisionit (/////)
- Burbuqe Rrahimi – Anëtar i komisionit (/////)
- Rexhep Haziri – Anëtar i komisionit (/////)

## Raporti i komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni Ri-vlerësues ka konstatuar:

### DEKLARATË:

Për Lot I: OE "BURASM GOLD" rekomandohet për kontrate sepse i plotësonte gjithë kriteret dhe ka çmimin me te ulet  
Për Lot II: OE "MALI-I" rekomandohet për kontrate sepse i plotësonte gjithë kriteret dhe ka çmimin me te ulet  
Për Lot III: OE "BURASM GOLD" rekomandohet për kontrate sepse i plotësonte gjithë kriteret dhe ka çmimin me te ulet  
Për Lot IV: OE "BURASM GOLD" rekomandohet për kontrate sepse i plotësonte gjithë kriteret dhe ka çmimin me te ulet

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues

EMRI I OPERATORËVE EKONOMIK QË KANË DORËZUAR TENDER TE PËRGJEGJSHËM	VENDI	ÇMIMI € (Euro)
N.P.T. "Mali-I"	Mitrovicë	Lot 2 = 186,121.40 €
"Bursa, Gold" Shpk	Prishtinë	Lot 3 = 51,500.00 € Lot 4 = 86,260.00 €

- Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka ardhë në përfundim se OE N.T.SH. "Delfina" – Malishevë, ka bërë gabime aritmetike mbi 2% per Lot 2 dhe 3, ndërsa OE të përgjegjshëm dhe kanë rekomanduar për kontratë OE: N.P.T. "Mali-I"-Mitrovicë, me çmim prej: Lot 2 = 186,121.40 € dhe OE: "Bursam Gold" Shpk - Prishtinë, me çmim prej: Lot 3 = 51,500.00 € dhe Lot 4 = 86,260.00 €

### Menaxheri i prokurimit aprovon/pajtohet me raportin e komisionit të vlerësimit.



Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: N.T.SH. "Delfina" – Malishevë, ndaj OE të rekomanduar për dhënie të kontratës për Lot 2: NPT "Mali-I" – Mitrovicë dhe Lot 3: "Burasam Gold" Shpk – Prishtinë.

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

### **Përgjigje në Pretendimi Nr. 1**

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar dispozitat ligjore ka shkëlur nenin 1, 6, 7, 59.4, 60.1.1 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit (në këtë aktivitet të prokurimit) komisioni i Ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk ka respektuar nenin 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit", si dhe nenin 7 par. 1 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", Po ashtu, autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit tek Pjesa B: Draft Kontrata Publike Kornize, Kushtet & Anekset e ndërlidhura – Kushtet e përgjithshme të Kontratës bazuar tek Neni 2 Kushtet e dërgesës, par. 2.3 po citoj: Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP<sup>4</sup> (Dërgesat e Detyrës të Paguara). - Vëmendje: DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara – Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Gjithashtu, eksperti shqyrtues sqaron bazuar edhe në interpretimin e KRPP-se nr. 46 tek pyetjet e shpeshta në web faqen e KRPP-së, po citoj: "Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë".

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë me ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të këtë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën me efikas, me transparent dhe me të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike. Andaj, AK – Qendra e Studenteve, nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së. Prandaj, në bazë të analizës së dokumentacionit të prezantuar, sqarimeve si më lart, pretendimet e palës në ankesë në këto pika/prendime janë të qëndrueshme.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: N.T.G. "Blendi" – Prishtinë, ndaj OE të rekomanduar për dhënie të kontratës për Lot 4: "Burasam Gold" Shpk – Prishtinë.

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

### **Përgjigje në Pretendimi Nr. 1**

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka vepruar sipas FDT-se dhe njoftimit për kontratë konkretisht nenin 1, 6, 7, 53.3 dhe 59 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit (në këtë aktivitet të prokurimit) komisioni i Ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit AK nuk ka respektuar nenin 7 par. 1 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente" nenin 52 par.3 Po citoj: "Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim" nenin 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit", prandaj, duke u bazuar në këto fakte dhe pasi që AK në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk ka kërkuar fare të prezantohen/dorëzohen mostrat pran AK, lidhur me LOT 4 andaj, duke pasqyruar nënën e lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë në këto pika janë të qëndrueshëm.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE: N.T.Sh. "Delfina" - Malishevë, N.T.G. "Blendi" – Prishtinë, "Europrinty" Shpk – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi me mobile për nevojat e konvikteve të Qendres së Studenteve, Lot 2, 3 dhe 4, me nr. prokurimi: 1020890500-19-1786-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Qendra e Studenteve.

S.B



**Eksperti shqyrtues sqaron**, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike. Prandaj, në bazë të analizës së dokumentacionit të prezantuar, sqarimeve si më lart, pretendimet e palës në ankesë në këto pika/pretendime janë të qëndrueshme.

### **Përgjigje në Pretendimi Nr. 2**

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar **nenin 28 të LPP-së** dhe **nenin 20** specifikimet teknike të RrUOPP.

**Eksperti shqyrtues sqaron** se pretendimi i operatorit ekonomik ankues lidhur me shkeljet lidhur me specifikat teknike, nëse OE ka pasur paqartësi dhe supozime se ka shkelje të këtij neni ka mundur të kërkojë sqarime shtese në afatin kohorë të përcaktuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit (nuk kam hasur në platformën elektronike nga OE ankues ndonjë kërkesë për sqarime apo kërkesë për rishqyrtim lidhur me njoftimin për kontratë), andaj OE ankues një gjë të tillë nuk e ka shfrytëzuar dhe nuk ka jap asnjë sqarim lidhur me këtë nenë tek deklarata detale mbi faktet dhe argumentet (është përgjegjësi e AK të vendos specifikimi teknike sipas LPP-se), prandaj konsideroj se nuk ka shkelje të këtij neni, duke u bazuar në këto fakte dhe duke pasqyruar analizën se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë **nuk qëndron**.

### **Përgjigje në Pretendimi Nr. 3**

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues se AK nuk ka respektuar **nenin 108/A par.2 të LPP-së**.

**Eksperti shqyrtues sqaron** se bazuar në Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Dhe AK është i obliguar menjëherë/automatiksht të pezullojë aktivitetin e prokurimit dhe të ngritë në platformën elektronike e-prokurimi, vendimin për pezullim të aktivitetit të prokurimit në pajtim me **nenin 108/A par. 2 të LPP-së**, po citoj: *“Dorëzimi i një kërkesë për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatiksht të pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar”*. Miro, gjatë shqyrtimit në platformën elektronike nuk kam hasur vendimin për pezullim nga AK, prandaj, në bazë të analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë është i qëndrueshëm.

**Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: “Europrinty” Shpk - Prishtinë, ndaj OE të rekomanduar për dhënie të kontratës për Lot 3: “Burasm Golg” Shpk – Prishtinë.**

*Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:*

### **Përgjigje në Pretendimi Nr. 1**

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar **nenin 28 të LPP-së** dhe **nenin 20** specifikimet teknike të RrUOPP.

**Eksperti shqyrtues sqaron** se pretendimi i operatorit ekonomik ankues lidhur me shkeljet lidhur me specifikat teknike, nëse OE ka pasur paqartësi dhe supozime se ka shkelje të këtij neni ka mundur të kërkojë sqarime shtese në afatin kohorë të përcaktuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit (nuk kam hasur në platformën elektronike nga OE ankues ndonjë kërkesë për sqarime apo kërkesë për rishqyrtim lidhur me njoftimin për kontratë), andaj OE ankues një gjë të tillë nuk e ka shfrytëzuar dhe nuk ka jap asnjë sqarim lidhur me këtë nenë tek deklarata detale mbi faktet dhe argumentet (është përgjegjësi e AK të vendos specifikimi teknike sipas LPP-se), prandaj konsideroj se nuk ka shkelje të këtij neni, duke u bazuar në këto fakte dhe duke pasqyruar analizën se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë në këto pika **nuk qëndrojnë**.

S-B



## **Përgjigje në Pretendimi Nr. 2**

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së dhe nenin 41 të RrUOPP.

Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit (në këtë aktivitet të prokurimit) komisioni i Ri-vlerësimit ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar, ofertën e OE ankues e ka vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së, duke rekomanduar për dhënie të kontratës. Mirëpo komisioni i veçantë për pranimin e mostrave në raportin e tij të datës 14.05.2019 nxjerr këtë konstatim, po citoj:

**1. Baza e karriges është material i pa plastifikuar**

**2. Mbështetja e karriges nuk është në përputhje me kriterin e kërkuar, mbështetësja nuk është me rrjet ekologjike.**

**3. Lartësia e mbështetës nga toka është nën minimalen 84 cm (duhet të jete 85 cm – 90 cm).**

Prandaj duke u bazuar në këto fakte dhe duke pasqyruar kërkesën e AK, analizës së mësipërme si dhe ankesën e OE ankues tek DEKLARAT DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET, jap këtë deklaratë/arsyetim po citoj: *“Karriget e prezantuar nga ana jone është edhe me e mire se në foto të cilën e kanë AK, karrige ka eco lëkur në ulësen, gjithashtu në kemi prezantuar mostrën edhe në mbështetëse eco lëkure që është më e mire se rrjeta dhe ka qenë e lartësisë siç është kërkuar”* që do të thotë se vet e pohon se nuk është sjellë mostra ashtu siç është kërkuar të specifikat teknik

Po ashtu në një pjesë tjetër OE ankues jep këtë deklaratë/arsyetim po citoj: *“në kemi bere të pamundurën për ta gjetur ashtu identike mostrën edhe pse në tregun tone nuk ka pasur këto behën vetëm me porosi nga China në kemi beret e pamundurën dhe ditën e fundit të cilën e kemi pasur për ta dorëzuar në kemi dërguar një mostër të ngjashme me të cilën ata na kanë kërkuar”.*

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit në këtë aktivitet të prokurimit dhe shkeljet dispozitave ligjore të LPP-së që kanë ndodhur në këtë procedure, rekomandoj AK që këtë aktivitet të prokurimit të kthejë në Ri-vlerësim dhe të vazhdojë të respektoj në tërësi dispozitat ligjore të LPP-së. Prandaj duke u bazuar në këto fakte dhe duke pasqyruar kërkesën e AK dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika është **pjesërisht të qëndrueshme.**

Gjithashtu, Eksperti Shqyrtues sqaron si në vijim: Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht e komisionit të vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit të tenderuesve, të trajtoj dhe analizoje çmimin, apo të konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me nenin 61 të LPP-së, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara në Aneksi 1, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura dhe rregullave ku janë të publikuar në web-faqen e KRPP-së, në formularin B57.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë të ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të këtë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrë të efikas, me transparent dhe me të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike. Andaj, AK – Qendra e Studenteve, nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së.

## **Mendimi i ekspertit shqyrtues**

Eksperti shqyrtues profesional, duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezantuara në dosjen e tenderit, raport, si dhe rrjedhën nga ana e AK-së, lidhur me tenderin e AK: QENDRA E STUDENTEVE, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me mobilje për nevoja të konvikteve në Qendra të Studenteve” – Lot: 2, 3, 4, me nr. prokurimi: 1020890500-19-1786-1-1-1,** lidhur me pretendimet ankimore si më poshtë:

Pretendimet ankimore të OE ankues N.T.SH. “Delfina” – Malishevë lidhur me rekomandimin e për dhënie të kontratës për Lot 2 dhe Lot 3 të aprovet si të bazuar, dhe të njëjtin tender rekomandojmë, Autoritetin Kontraktues, që të rishyrtoj edhe një herë vendimin e vet dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Pretendimet ankimore të OE ankues N.T.G. “Blendi” – Prishtinë, lidhur me rekomandimin e për dhënie të kontratës për Lot 4.; të aprovet si të bazuar, dhe të njëjtin tender rekomandojmë, Autoritetin Kontraktues, që të rishyrtoj edhe një herë vendimin e vet dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Rivlerësim

Pretendimet ankimore të OE ankues “Europrinty” Shpk - Prishtinë lidhur me rekomandimin e për dhënie të kontratës për Lot 3.; të aprovet si pjesërisht e bazuar, dhe të njëjtin tender rekomandojmë, Autoritetin Kontraktues, që të rishyrtoj edhe një herë vendimin e vet dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Rivlerësim